



Një udhëzues për të drejtat e prindërve në edukimin special

Njoftimi për masat procedurale për edukimin special

Prill 2017

Ohio | Department
of Education



Mbi edukimin special

Edukimi special, për studentët e moshave 3 deri në 21 vjeç, drejtohet nga kërkesat shtetërore dhe federale. Kërkesat federale përmenden si Akti për Edukimin për individët me aftësi të kufizuara (IDEA). Kërkesat shtetërore përmenden si Standardet operative të Ohajos për edukimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara (Standardet operative të Ohajos).

Ky udhëzues mund t'ju ndihmojë të kuptoni të drejtat tuaja dhe të drejtat e fëmijëve tuaj sipas IDEA dhe Standardeve operative të Ohajos. Ai gjithashtu ju siguron informacione dhe burime për t'ju ndihmuar të kuptoni shërbimet dhe mbështetjet për edukimin special për fëmijën tuaj.

Distrikti lokal i shkollës gjithashtu mund t'ju ndihmojë që të kuptoni të drejtat tuaja sipas këtij ligji. Nëse keni pyetje për informacionet në këtë udhëzues, kontaktoni me drejtorin e edukimit special për distriktin tuaj.

Kontakti i shkollës për edukimin special

Distrikti: *Shtoni informacionet e mëposhtme në këtë seksion interaktiv:*

Drejtori i edukimit special:

Numri i telefonit:

Adresa e emailit:

Departamenti i Ohajos i Kontaktit për Edukimin Special

(Telefoni) 614-466-2650

(Pa pagesë) 877-644-6338

(Faksi) 614-728-1097

25 S. Front Street, Mail Stop 409
Kolumbi, Ohajo 43215

Exceptionalchildren@education.ohio.gov

Për telefonuesit që përdorin një teleshkrues (TTY), telefononi në Shërbimin e Ritransmetimit të Ohajos në numrin (800) 750-0750.

Informacione të tjera për kontaktin <http://bit.ly/2hgiNa1>

Prezantimi për këtë udhëzues për të drejtat e prindërve

Akti për edukimin për individët me aftësi të kufizuara (IDEA) mbron të drejtat e studentëve me aftësi të kufizuara si dhe të drejtat e prindërve. Ky udhëzues ju tregon për ato të drejta. Shkolla juaj duhet t'ju japë një kopje të udhëzuesit një herë në vit nëse fëmija juaj merr shërbime të edukimit special. Ju gjithashtu duhet të merrni një kopje:

- Nëse kërkonit që fëmija juaj të vlerësohet pasi mendoni se fëmija juaj mund të ketë një aftësi të kufizuar;
- Nëse distrikti i shkollës kërkon që të vlerësojë fëmijën tuaj pasi mendon se fëmija juaj mund të ketë një aftësi të kufizuar;
- Nëse paraqitni (dorëzoni) një *ankesë* - me shkrim - në Zyrën për fëmijët e veçantë në Departamentin e Edukimit të Ohajos, dhe është ankesa juaj e *parë* e vitit shkollor;
- Nëse paraqitni (dorëzoni) një *kërkesë* - me shkrim - në Zyrën për fëmijët e veçantë në Departamentin e Edukimit të Ohajos për një *seancë për procesin e rregullt* në lidhje me edukimin e fëmijës tuaj, dhe është hera e parë në vitin shkollor që keni kërkuar për një të tillë;
- Nëse fëmija juaj është *larguar nga shkolla për arsye disiplinore (të sjelljes)* - dhe fëmija juaj është larguar tashmë nga shkolla për 10 ditë ose më shumë gjatë vitit shkollor aktual; ose
- Çdo herë që *kërkonit një kopje të udhëzuesit*.



Tabela e përmbajtjes

Informacione të përgjithshme	5
Pëlqimi prindëror i informuar A është fëmija juaj i përshtatshëm për edukimin special? Vlerësimet edukative të pavarura Njoftimi paraprak me shkrim	
Regjistrat arsimore	10
Mundësia e aksesit për regjistrat	
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve	12
Proçesi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve Zgjidhja e hershme e ankesave Lehtësimi Ndërmjetësimi Paraqitja e një ankese shtetërore Proçesi për ankesën shtetërore Paraqitja e një ankese për proçesin e rregullt Proçesi i rregullt Kronologjia dhe proçesi Zgjidhja për proçesin e rregullt Proçesi i seancës dëgjimore Apelimi i një vendimi Statusi i fëmijës gjatë proçesit të rregullt Tarifat e avokatit	
Disiplina	29
Proçedurat disiplinore për fëmijët me aftësi të kufizuara Përcaktimi i manifestimit Kudri i përkohshëm arsimor alternativ	
Caktimi i njëanshëm i programit të edukimit për fëmijët me aftësi të kufizuara nga prindërit në një shkollë private me shpenzime publike	32
Proçesi i përcaktimit të rimbursimit	
Njoftimi për prindërit për programet e bursave për studentët me aftësi të kufizuara	33
Kur bëhen njoftimet	

Informacione të përgjithshme

Pëlqimi prindëror i informuar

Pëlqimi prindëror i informuar do të thotë se ju dhe/ose prindi zëvendësues i caktuar nga distrikti jepni lejen, me shkrim, që distrikti i shkollës të ndërmarrë një veprim. Leja juaj do të thotë po ashtu që distrikti j ka dhënë informacione për veprimin e propozuar. Distrikti i shkollës së fëmijës tuaj duhet ta marrë këtë leje nga ju, me shkrim, për të kryer gjëra të caktuara në lidhje me edukimin special të fëmijës tuaj. Distrikti i shkollës duhet të marrë lejen tuaj me shkrim:

- Para se distrikti të vlerësojë fëmijën tuaj për herë të parë për të zbuluar nëse fëmija juaj ka nevojë për edukim special dhe shërbimet përkatëse;
- Para se distrikti të fillojë të japë shërbimet e edukimit special për fëmijën tuaj që renditen në programin e parë edukativ të individualizuar, të quajtur po ashtu IEP;
- Para se distrikti të vlerësojë përsëri fëmijën tuaj për të zbuluar nëse nevojat e fëmijës tuaj kanë ndryshuar;
- Para se distrikti të kryejë vlerësime të tjera me fëmijën tuaj. Një shembull i tillë do të ishte një Vlerësim Funkcional i Sjelljes;
- Para se distrikti të ndryshojë programin e caktuar të edukimit për fëmijën tuaj. Kjo nuk do të thotë domosdoshmërisht një ndryshim në vendndodhje. Kjo do të thotë më shumë një ndryshim në programin edukativ të fëmijës tuaj; dhe
- Para se distrikti t'i japë informacione për fëmijën tuaj dikujt tjetër nga ata që renditen në ligjin shtetëror ose federal.

Çfarë është një prind zëvendësues?

Një prind zëvendësues është një individ që mund ta përfaqësojë një fëmijë me një aftësi të kufizuar në të gjitha çështjet në lidhje me kualifikimin për shërbimet e edukimit special dhe marrjen e këtyre shërbimeve.

Distrikti i shkollës ku jetoni cakton një prind zëvendësues kur ndodh një nga të mëposhtmet:

- Prindi nuk mund të identifikohet;
- Distrikti i shkollës, pas përpjekjeve të arsyeshme, nuk mund të gjejë vendndodhjen e prindit;
- Fëmija është një i ri i pastrehë dhe i pashoqëruar; ose
- Fëmija është në kujdes ligjor shtetëror.

Pëlqimi prindëror i informuar nuk kërkohet kur ndodh një nga të mëposhtmet:

- Distrikti po rishikon informacionet ekzistuese të studentëve si pjesë e procesit të vlerësimit/rivlerësimit; ose
- Distrikti kryen vlerësime me fëmijën tuaj që administrohen për të gjithë studentët.



Për dhënien e pëlqimit prindëror të informuar, distrikti:

- Duhet të sigurohet që ka përdorur gjuhën tuaj amtare ose një formë tjetër komunikimi që ju e kuptoni, për t'ju dhënë të gjitha informacionet që ju duhen për të marrë një vendim;
- Duhet të siguroheni që e kuptoni dhe pranoni me shkrim që distrikti të kryejë një aktivitet dhe pëlqimi juaj përshkruan aktivitetin, si dhe çdo regjistrim për fëmijën tuaj që do të ndahet me të tjerët dhe se me kë;
- Duhet të siguroheni që ju e kuptoni se po jepni pëlqimin tuaj sipas zgjedhjes tuaj dhe mund të ndryshoni mendim në çdo kohë;
- Duhet të sigurohet që e kuptoni se nëse e anuloni pëlqimin tuaj, distrikti nuk është i detyruar të zhbëjë asnjë veprim që ka kryer në periudhën nga dhënia e lejes tuaj deri në anulimin e saj.

Anulimi i pëlqimit

Anulimi i pëlqimit do të thotë se ju e tërhiqni lejen e dhënë. Mund ta anuloni pëlqimin tuaj në çdo kohë nëse vendosni që nuk dëshironi që fëmija juaj të marrë shërbime të edukimit special siç ofrohen në programin IEP për fëmijën tuaj. Këtë duhet ta bëni **me shkrim**.

Më pas, distrikti juaj i shkollës:

- Duhet të ndalojë ofrimin e shërbimeve të edukimit special për fëmijën tuaj në programin IEP, por përpara se të ndalojë ofrimin e shërbimeve, distrikti duhet t'ju njoftojë me shkrim se po ndalon shërbimet. Njoftimi që ju jepet nga distrikti quhet njoftimi paraprak me shkrim. Ky njoftim paraprak me shkrim duhet të përmbushë kërkesat e përcaktuara në pjesën Njoftimi paraprak me shkrim në faqen 9 të këtij udhëzuesi.

Pasi distrikti t'ju ketë dhënë këtë njoftim paraprak me shkrim ku thuhet se nuk do të ofrojë më shërbimet e edukimit special për fëmijën tuaj dhe pasi të ndalojnë shërbimet, distrikti nuk do ta konsiderojë më fëmijën tuaj si të përshtatshëm për edukimin special dhe në vend të kësaj do ta konsiderojë fëmijën tuaj si një student të edukimit të përgjithshëm.



A është fëmija juaj i përshtatshëm për edukimin special?

Të qenit i përshtatshëm thjesht do të thotë se fëmija juaj ka rezultuar se ka nevojë për shërbime edukative të caktuara për shkak të një ose më shumë aftësive të kufizuara. Ligji për edukimin për individët me aftësi të kufizuara (IDEA) kërkon që studentët me aftësi të kufizuara të marrin edukim special dhe/ose shërbimet përkatëse. Për t'u konsideruar një student me një aftësi të kufizuar sipas këtij ligji, fëmija juaj duhet të kërkojë edukimin special dhe/ose shërbimet përkatëse për shkak të aftësisë së tij ose të saj të kufizuar në një ose më shumë nga kategoritë e mëposhtme të aftësive të kufizuara:

- Aftësi e kufizuar intelektuale;
- Dëmtim i dëgjimit;
- Dëmtim i të folurës ose i gjuhës;
- Dëmtim i shikimit;
- Shqetësime emocionale;
- Dëmtim ortopedik;
- Autizëm;
- Dëmtim traumatik i trurit;
- Dëmtime të tjera për shëndetin;
- Aftësi e kufizuar specifike për të mësuarit;
- Shurdhësi;
- Shurdhësi-verbëri;
- Aftësi të kufizuara të shumta; ose
- Vonesa të zhvillimit.

Gjuha amtare ose një mënyrë tjetër e komunikimit

Të gjitha takimet ku merrni pjesë, vlerësimi i fëmijës tuaj dhe të gjitha njoftimet që merrni duhet të jenë me shkrim ose me të folur në gjuhën tuaj amtare ose një mënyrë tjetër e komunikimit që ju përdorni.

Të gjitha testet dhe materialet e tjera të përdorura për të vlerësuar fëmijën tuaj duhet të jenë në gjuhën amtare të fëmijës tuaj - ose një mënyrë tjetër komunikimi që do t'i sigurojë distriktit informacione të sakta për ata që fëmija juaj di në nivel akademik, funksional dhe zhvillimi, përveçse nëse nuk është qartësisht e mundshme për t'u siguruar ose administruar.

Kërkojini distriktit të vlerësojë fëmijën tuaj

Nëse mendoni se fëmija juaj ka një aftësi të kufizuar që ndikon në edukimin e tij ose të saj, mund t'i kërkonte distriktit që të vlerësojë fëmijën tuaj për të përcaktuar nëse ai ose ajo është i përshtatshëm për edukimin special (konsiderohet si një fëmijë me një aftësi të kufizuar sipas ligjit IDEA). Distrikti i shkollës mund t'ju pyesë po ashtu në çdo kohë nëse dëshironi që fëmija juaj të vlerësohet në rast se anëtarët e personelit të distriktit mendojnë se fëmija juaj mund të ketë nevojë për edukim special. Në çdo rast, pasi distrikti i shkollës të ketë marrë lejen tuaj (pëlqimin) me shkrim, ai duhet të përfundojë vlerësimin fillestar (të parë) brenda 60 ditëve kalendarike.

Nëse fëmija është në kujdes ligjor shtetëror

Nëse fëmija është **në kujdes ligjor shtetëror** dhe nuk jeton me prindin e tij ose të saj, distrikti i shkollës nuk ka nevojë për pëlqim nga prindi për një vlerësim fillestar për të përcaktuar nëse një fëmijë ka një aftësi të kufizuar në situatat e mëposhtme:

- Nëse, pavarësisht përpjekjeve të arsyeshme për të bërë këtë, distrikti i shkollës nuk mund të gjejë vendndodhjen e prindit të fëmijës;
- Të drejtat e prindërve janë pezulluar; ose
- Një gjykatës i ka caktuar të drejtat e prindërve një individ që jep pëlqimin për vlerësimin fillestar.

Vlerësimet arsimore të pavarura (IEE)

Një vlerësim edukativ i pavarur (IEE) quhet po ashtu një vlerësim i jashtëm. Distrikti i shkollës do të paguajë për këtë vlerësim të jashtëm vetëm nëse e ka kryer tashmë vlerësimin e saj për fëmijën tuaj dhe ju nuk i pranoni rezultatet e distriktit. Qëllimi është që të zbulohet nëse fëmija juaj ka nevojë për një edukim special ose vazhdon të ketë nevojë për një edukim special. Personi që vlerëson fëmijën tuaj për këtë vlerësim të jashtëm nuk mund të punojë për distriktin e shkollës së fëmijës tuaj. Si prind, ju keni të drejtën që të organizoni dhe të paguani në çdo kohë për një vlerësim të jashtëm për fëmijën tuaj. Kur ju nuk e pranoni vlerësimin e distriktit tuaj për fëmijën tuaj dhe kërkon një vlerësim të jashtëm, distrikti juaj duhet të ndërmarrë një nga këto veprime pa asnjë vonesë të panevojshme:

- Distrikti i shkollës duhet t'ju tregojë se ku mund të realizoni vetë një vlerësim të jashtëm të fëmijës tuaj dhe t'ju informojë për kriteret e nevojshme që distrikti të paguajë për të. Kur distrikti të pranojë dhe të kryeni vlerësimin e jashtëm, distrikti duhet të paguajë koston; ose
- Distrikti duhet të paraqesë një kërkesë pranë Zyrës për fëmijët e veçantë të Departamentit të Edukimit të Ohajos për një seancë për procesin e rregullt (shikoni faqen 21) pasi nuk e pranon kërkesën tuaj për një vlerësim të jashtëm. Kjo mund të ndodhë pasi distrikti mendon se vlerësimi i tij për fëmijën tuaj ka qenë i përshtatshëm.


Kriteret për vlerësimet e jashtme

Të njëjtat kriteret që zbatohen për vlerësimet që zbatohen nga distrikti gjejnë zbatim edhe për vlerësimet e jashtme që organizojnë prindërit dhe që paguhen nga distrikti. Këto kriteret përfshijnë vendet ku mund të shkojë fëmija juaj për vlerësimin dhe eksperiencën e personit që e ekzaminon fëmijën tuaj. Distrikti duhet të paguajë koston e plotë të një vlerësimi të jashtëm që i plotëson kriteret e distriktit.

Nëse kërkon një vlerësim të jashtëm për fëmijën tuaj, distrikti mund t'ju pyesë se **pse** nuk e pranoni vlerësimin e distriktit për fëmijën tuaj (d.m.th. arsyet pse dëshironi një vlerësim të jashtëm), por nuk është e nevojshme të shpjegoheni nëse nuk dëshironi ta bëni këtë. Ju keni të drejtën për një vlerësim të jashtëm të paguar nga distrikti, për çdo rast që distrikti vlerëson fëmijën tuaj dhe ju nuk i pranoni rezultatet e vlerësimit të distriktit tuaj.

Pasi për fëmijën tuaj të jetë kryer një vlerësim i jashtëm që plotëson kriteret e distriktit, pavarësisht se kush paguan për të, distrikti duhet të marrë parasysh rezultatet e atij vlerësimi dhe të përcaktojë se si do të ofrojë për fëmijën tuaj një edukim publik falas të përshtatshëm (FAPE).

Skema e mëposhtme tregon skenarët e ndryshëm që ndodhin kur kërkon një vlerësim të jashtëm



Përmbledhja

Një distrikt shkollor duhet t'ju japë një njoftim me shkrim (i quajtur një njoftim paraprak me shkrim) brënda një kohe të arsyeshme para se të propozojë ose të refuzojë veprime të caktuara. Këto veprime përfshijnë fillimin ose ndryshimin e identifikimit, vlerësimin ose caktimin e programit të edukimit për fëmijën tuaj ose ofrimin e një edukimi publik falas të përshtatshëm për fëmijën tuaj nga ana e distriktit. Njoftimi paraprak me shkrim është një formular i detyrueshëm i edukimit special.

Përmbajtjet e njoftimeve paraprake me shkrim

Një njoftim paraprak me shkrim duhet të japë detaje të mjaftueshme për t'ju lejuar të merrni pjesë në vendimet për shërbimet edukative të fëmijës tuaj në një mënyrë të informuar. Në mënyrë të veçantë, njoftimi paraprak me shkrim duhet të përfshijë përmbajtje të caktuara, siç përcaktohet në kutinë shoqëruese në këtë faqe.

Njoftimi paraprak me shkrim në një gjuhë të kuptueshme

Njoftimi paraprak me shkrim duhet të jepet në një gjuhë që është e kuptueshme për publikun e përgjithshëm dhe është e shkruar po ashtu në gjuhën tuaj amtare ose në një mënyrë tjetër komunikimi, përveçse nëse është e qartë se kryerja e kësaj nuk është e mundur.

Nëse gjuha amtare e prindit ose mënyra tjetër e komunikimit **nuk** është një gjuhë me shkrim, atëherë distrikti duhet të ndërmarrë hapa për të përkthyer me gojë njoftimin paraprak me shkrim, ose me një mënyrë tjetër të kuptueshme, në gjuhën amtare të prindit ose një mënyrë tjetër komunikimi. Distrikti do të duhet të sigurojë që mund të tregojë, me shkrim, se njoftimi paraprak me shkrim është përkthyer si duhet dhe se prindi e ka kuptuar përmbajtjen e tij.

Njoftimi paraprak me shkrim duhet të përfshijë:

- Një përshkrim të veprimit të propozuar ose të refuzuar nga distrikti;
- Një shpjegim se pse distrikti propozon ose refuzon të ndërmarrë veprimin;
- Një përshkrim të çdo procedurë vlerësimi, vlerësimi, regjistrimi ose raporti që shkolla përdor për të marrë vendimin e saj;
- Një deklaratë që prindërit kanë mbrojtje sipas masave mbrojtëse procedurale të ligjit IDEA dhe, nëse njoftimi nuk është një rekomandim fillestar për vlerësimin, mjetet se si prindi mund të marrë një përshkrim të masave mbrojtëse procedurale;
- Burimet për prindërit për të kontaktuar për ndihmë për të kuptuar kërkesat e ligjit IDEA;
- Një përshkrim të opsioneve të tjera që ka marrë parasysh ekipi i programit IEP dhe arsyet pse ato opsione janë refuzuar;
- Një përshkrim të faktorëve të tjera që kanë lidhje me propozimin ose refuzimin e distriktit.



Regjistrimet arsimore

Mundësia e aksesit për regjistrat

Ligji për privatësinë dhe të drejtat arsimore të familjes (FERPA) është një ligj federal që u jep prindërve të drejta të caktuara për të kontrolluar dhe rishikuar regjistrimet edukative të fëmijëve të tyre. Të drejtat sipas ligjit FERPA transferohen nga prindërit te studenti kur studenti arrin 18 vjeç ose më shumë ose kur fillon shkollën e nivelit të dytë (p.sh. një kolegji ose universitet), cila të ndodhë më parë.

Çfarë janë regjistrat arsimorë?

Nëse informacione të caktuara për një student mbrohen nga ligji FERPA, kjo varet nga fakti nëse artikulli e plotëson kuptimin e një regjistrimi arsimor. Në ligjin FERPA, regjistrimet arsimore përkufizohen si:

1. Regjistrimet që janë të lidhura drejtpërdrejt me një student. Ndonjëherë shkollat i quajnë këto informacione personalisht të identifikueshme; dhe
2. Regjistrime që mbahen nga një agjenci arsimore ose institucion arsimor (për shembull, distrikti i shkollës) ose një palë që punon për atë agjenci.

Mirëmbajtja dhe konfidencialiteti i regjistrimeve

Regjistrimet arsimore mund të mbahen në shumë mënyra. Disa shembuj janë:

- Me shkrim dore;
- Të printuara;
- Në kompjuter;
- Me videokaseta ose kaseta audio; ose
- Film, mikrofilm ose mikrofisha.

Regjistrimet e studentit janë konfidenciale, që do të thotë se ato janë **private**. Distrikti i shkollës ose agjencia duhet të mbrojtë privatësinë e regjistrimeve të fëmijës tuaj kur i mbledh, ruan, publikon ose i shkatërron ato.

Rishikimi i regjistrimeve të fëmijës tuaj

Distrikti i shkollës duhet t'ju lejojë që të rishikoni regjistrimet arsimore për fëmijën tuaj pa asnjë vonesë të panevojshme dhe para çdo takimi të ekipit të programit IEP ose çdo procedurë për procesin e duhur ku jeni të përfshirë. Distrikti nuk mund të presë për më shumë se 45 ditë nga data e kërkesës tuaj për t'ju lejuar të rishikoni regjistrimet.

Ju keni të drejtën të rishikoni vetëm informacionet në regjistrimin që ka lidhje me fëmijën **tuaj**. Ju keni të drejtën t'i kërkonti shkollës një shpjegim për regjistrimet e fëmijës tuaj. Ju keni të drejtën që dikush tjetër, në emrin tuaj, të ekzaminojë regjistrimet (si p.sh. një mik ose një avokat).

Distrikti mund t'ju japë kopje të regjistrimeve të fëmijës tuaj; sidoqoftë, distrikti **duhet** t'ju japë kopje në rast se mosrealizimi i kësaj gjëje mund t'ju pengojë të ushtroni të drejtën tuaj për rishikimin e regjistrimeve. Ju keni gjithmonë të drejtën të merrni kopje të regjistrimeve tuaja me shpenzimet tuaja.

Informacionet personalisht të identifikueshme përfshijnë:

- Emrin e fëmijës;
- Emrin e një anëtarit të familjes;
- Adresën e fëmijës ose adresën e familjes;
- Një identifikim personal, si p.sh. numrin e sigurimeve shoqërore të fëmijës, numrin e studentit ose regjistrimin biometrik;
- Mënyra të tjera jo të drejtpërdrejta për identifikimin e fëmijës tuaj, si p.sh. data e lindjes, vendi i lindjes, mbiemri i vajzërisë i nënës, raca ose etnia;
- Informacione të tjera që, vetëm ose të kombinuara, janë të lidhura ose mund të lidhen me një student specifik që do të lejonte që një person i arsyeshëm në komunitetin e shkollës, i cili nuk ka njohuri personale për rrethanat përkatëse, të identifikojë studentin me një siguri të arsyeshme;
- Informacione të kërkuara nga një person që shkolla beson se ka njohuri për identitetin e fëmijës tuaj; ose
- Shembuj të tjerë siç përcaktohet nga FERPA.



Ndryshimet në regjistrimet arsimore

Ju keni të drejtën që t'i kërkonti distriktit të shkollës që të ndryshojë informacione të gabuara ose çorientuese në regjistrimet edukative të fëmijës tuaj. Shkolla e fëmijës tuaj nuk është e detyruar të ndryshojë regjistrimet arsimore sipas kërkesës tuaj (thjesht sepse e kërkuat ju), por shkolla duhet **ta marrë në konsideratë** kërkesën tuaj. Nëse shkolla juaj vendos që të mos e ndryshojë regjistrimin për fëmijën tuaj siç keni kërkuar ju, shkolla duhet t'ju informojë se keni të drejtën për një seancë dëgjimore për të folur për këtë çështje.

Pas seancës, nëse shkolla vendos përsëri që të mos e ndryshojë një regjistrim arsimor, ju keni të drejtën të përfshini deklaratën tuaj mbi këtë çështje në regjistrimin e fëmijës tuaj. Kjo deklaratë duhet të qëndrojë si pjesë e regjistrimit të fëmijës tuaj. Opsioni për të shkruar një deklaratë për t'u përfshirë në regjistrimin e fëmijës tuaj ekziston **vetëm nëse regjistrimet përfshijnë informacione të gabuara**. Nuk mund ta përdorni një deklaratë të tillë për të kundërshtuar një notë që ka marrë fëmija juaj, një opinion të një individi ose një vendim të pavarur të marrë nga shkolla për fëmijën tuaj.

Ndarja e regjistrimeve arsimore

Zakonisht, distrikti i shkollës duhet të marrë lejen tuaj me shkrim nëse dëshiron që të ndajë me dikë tjetër, të ndryshëm nga ju, regjistrimet arsimore që identifikojnë fëmijën tuaj Sidoqoftë, ka disa raste kur leja juaj nuk kërkohet. Për të mësuar më shumë se kur një distrikt **nuk** është e nevojshme të marrë lejen tuaj me shkrim për ndarjen e regjistrimeve, shikoni [udhëzimet e përgjithshme të ligjit FERPA për prindërit](#) në Shtetet e Bashkuara. Faqja e internetit e Departamentit të Edukimit në www.ed.gov.



Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Procesi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve

Nëse jeni të shqetësuar për edukimin e fëmijës tuaj me një aftësi të kufizuar, hapi i parë është të bashkëpunoni me distriktin e shkollës. Për të filluar, kontaktoni me mësuesin e fëmijës tuaj ose me drejtorin e edukimit special të distriktit tuaj. Tregojini këtij personi se çfarë po mendoni. Nëse ju dhe distrikti nuk jeni dakord për shqetësimin tuaj, ka mënyra se si mund të punoni së bashku për ta zgjidhur problemin.

Këto procese kanë emra zyrtarë që mund të përdoren nga distrikti i shkollës, por ky udhëzues do t'ju ndihmojë të kuptoni se çfarë do të thonë ata emra dhe se si ju dhe shkolla mund ta ndihmoni fëmijën tuaj. Pjesa e mëposhtme përshkruan këto procese ose metoda që mund t'i përdorni për të punuar së bashku me distriktin tuaj.

Rishikimi administrativ

Nëse nuk jeni dakord me vendimin e distriktit të shkollës në lidhje me edukimin e fëmijës tuaj me një aftësi të kufizuar, mund të dorëzoni një ankesë tek administrata e distriktit. Në përgjigje të saj, kryeinspektori i distriktit (ose një i emëruar) do të kryejë një rishikim administrativ. Ky rishikim mund të përfshijë një seancë dëgjimore administrative.

Rishikimi dhe seanca dëgjimore administrative, nëse zhvillohet një e tillë, duhet të realizohen në një vend dhe kohë që janë të përshtatshme për të gjithë pjesëmarrësit e kërkuar. Ju dhe distrikti mund të ftoni të tjerë për të marrë pjesë në seancën administrative ose të rishikimi. Për shembull, mund të ftoni anëtarë të tjerë të familjes ose një shok, dikë që ka njohuri për edukimin special ose një avokat. Nëse fëmija juaj merr arsim në një program të drejtuar nga një bord i kontesë për aftësitë e kufizuara të zhvillimit ose një agjenci tjetër e arsimit publik, distrikti duhet të këshillohet me bordin ose agjencinë për rishikimin administrativ.

Gjatë rishikimit të situatës, duhet të bëhet çdo përpjekje e mundshme për të zgjidhur mosmarrëveshjen për edukimin e fëmijës tuaj. Kryeinspektori (ose një i emëruar) do të dëgjojë të dyja anët e mosmarrëveshjes dhe do të marrë një vendim. Pas marrjes së një vendimi, kryeinspektori duhet t'ju njoftojë me shkrim për vendimin. Kjo duhet të ndodhë brënda 20 ditëve nga momenti kur e keni njoftuar për herë të parë distriktin për shqetësimin tuaj.

Proçeset e tjera që mund të provoni

Nëse e keni përfunduar këtë proces dhe ju ose distrikti i shkollës nuk jeni ende dakord se si ta zgjidhni problemin, ka procese të tjera që mund t'i provoni. Ndërkohë që nuk jeni të detyruar të kërkonin një rishikim administrativ para se të kaloni në procese të tjera për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, ky proces është i këshilluar. Ka opsione të tjera që mund të përdorni për të zgjidhur problemin. Zyra për fëmijët e veçantë të Departamentit të Edukimit të Ohajos mund të përfshihet dhe t'ju ndihmojë për kërkesën tuaj për mjete të tjera për zgjidhjen e shqetësimeve tuaja. Entet e mëposhtme mund t'ju ndihmojnë po ashtu:

- Ekipi lokal i mbështetjes shtetërore (Rajoni # _____) në (telefoni # _____). Konsulenti për prindin dhe familjen në Ekipin e mbështetjes shtetërore do të bashkëpunojë me ju.
- Këshilltari lokal i prindërve, nëse distrikti i shkollës tuaj ka një të tillë.
 - Një këshilltar për prindërit siguron informacione dhe mbështetje për familjet e një fëmije me një aftësi të kufizuar si dhe distriktet e shkollave. Këshilltari për prindërit është një punonjës i distriktit dhe është po ashtu prindi i një fëmije me një aftësi të kufizuar.
 - Për më shumë informacione, kontaktoni me _____.
- Koalicioni i Ohajos për Edukimin e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara (OCECD)
 - OCECD është një organizatë jofitimprurëse mbarështetërore që u shërben familjeve të foshnjave, fëmijëve parashkollorë, fëmijëve në shkollë dhe të rinjve me aftësi të kufizuara në Ohajo, si dhe mësuesve dhe agjencive që u ofrojnë shërbime atyre. Programet e organizatës OCECD ndihmojnë që prindërit të bëhen përfaqësues të informuar dhe efektivë për fëmijët e tyre në të gjitha aspektet edukative.
 - Për më shumë informacione, kontaktoni me OCECD në (740) 382-5452 ose vizitoni faqen e internetit të OCECD në: www.oecd.org.

Zgjidhja e hershme e ankesave

Zgjidhja e hershme e ankesës është kur ju përpiqeni të zgjidhni diferencat me distriktin e shkollës në mënyrë jo zyrtare dhe zakonisht para se të filloni të përdorni opsionet e tjera për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Dikush nga Zyra për fëmijët e veçantë të Departamentit të Edukimit të Ohajos do të bashkëpunojë me ju për t'ju ndihmuar në trajtimin e pyetjeve dhe shqetësimeve tuaja në lidhje me edukimin e fëmijës tuaj.

Departamenti i Edukimit të Ohajos inkurajon zgjidhjen e hershme të ankesave para se të kërkonti procese më zyrtare, si p.sh. ankesat me shkrim apo seancat për procesin e rregullt. Mund të kontaktoni me dikë nga Zyra për fëmijët e veçantë të Departamentit të Edukimit të Ohajos për t'ju ndihmuar në trajtimin e pyetjeve dhe shqetësimeve tuaja në lidhje me edukimin e fëmijës tuaj. Për të folur me dikë për zgjidhjen e hershme të ankesave, kontaktoni me Departamentin:

- Me telefon: (614) 466-2650, ose pa pagesë në (877) 644-6338; ose
- Me email: exceptionalchildren@education.ohio.gov.

Lehtësimi

Nëse jeni të shqetësuar për vlerësimin ose rivlerësimin e fëmijës tuaj për edukimin special, ose për Programin e edukimit të individualizuar (IEP) të fëmijës tuaj, një opsion që quhet lehtësimi mund të funksionojë për ju.

Lehtësimi është kur i kërkonti Departamentit që të organizojë pjesëmarrjen e një lehtësuesi në një takim për vlerësimin e fëmijës tuaj ose me ekipin e programit IEP (ju jeni po ashtu një anëtar i këtij ekipi). Distrikti i shkollës mund të bëjë po ashtu një kërkesë për Departamentin për një lehtësues në një nga këto takime që kanë lidhje me edukimin special të fëmijës tuaj. Ju dhe distrikti duhet të pranoni së bashku që lehtësuesi të jetë e pranishëm në takim.

Qëllimi i lehtësimit

Lehtësimi zhvillohet në një takim të ekipit, si p.sh. një takim i ekipit të programit të edukimit të individualizuar, takim për planifikimin e vlerësimit ose takim i ekipit të vlerësimit. Lehtësuesi është një palë e tretë dhe neutrale që nuk është anëtar i ekipit dhe nuk merr vendime për ekipin. Pjesëmarrja e një lehtësuesi e ndihmon ekipin të jetë produktiv dhe të qëndrojnë i fokusuar te studenti. Lehtësuesit janë ndërmjetës profesionistë që janë trajnuar nga Zyra për fëmijët e veçantë për proceset e edukimit special.

Mund të kërkonti një lehtësim të tillë në çdo kohë. Pasi të bëni këtë, ju dhe distrikti i shkollës duhet të pranoni së bashku për pjesëmarrjen. Nëse pranoni të dyja palët, Zyra për fëmijët e veçantë do t'ju japë mundësitë e zgjedhjes për një lehtësues për drejtimin e takimit. Nëse ju dhe distrikti nuk mund të bini dakord për një lehtësues, zyra do të caktojë një të tillë për ju. Nuk ka kosto për ju ose distriktin për procesin e lehtësimit.

Lehtësuesi:

- Qëndron si një palë e tretë neutrale (nuk mban anë ose nuk punon për ju apo për distriktin);
- Është një **ndërmjetës** i trajnuar në mënyrë profesionale (një person i kualifikuar që ndihmon në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve);
- Është trajnuar dhe ka njohuri për ligjet dhe kërkesat për edukimin special;
- Nuk është pjesë e programit IEP ose ekipit të vlerësimit për fëmijën tuaj;
- Nuk merr vendime, por udhëzon ekipin për të gjetur zgjidhjet;
- Ndhmon për të hapur bashkëbisedimin mes jush dhe distriktit;
- E mban takimin në drejtimin e duhur dhe ndihmon që të gjithë të respektojnë procesin; dhe
- E mban ekipin të fokusuar te fëmija juaj dhe nevojat e fëmijës tuaj.



Pikat kryesore për t'u kujtuar për lehtësimin:

- **Lehtësimi është vullnetar.**
 - Prindi dhe distrikti i shkollës duhet të pranojnë së bashku që të jenë pjesë e procesit. Nëse prindi dhe distrikti pranojnë që të kenë një lehtësues në një takim, kjo nuk do të thotë se duhet të bini dakord me distriktin në takim ose të bini dakord me përfundimin e takimit. Prindërit lejohet gjithmonë që të kenë opinionet e tyre.
- **Çdo marrëveshje e bërë gjatë një takimi lehtësimi është në përgjithësi detyruese. Kjo do të thotë se prindi dhe distrikti i shkollës duhet të respektojnë marrëveshjen pas marrjes së vendimit së bashku.**
 - Çdo dokument që prindi dhe distrikti nënshkruajnë për vlerësimin ose programin IEP të fëmijës tuaj ka të njëjtën peshë si dokumentet që kanë nënshkruar në çdo takim të ekipit të vlerësimit ose të programit IEP.

Për më shumë informacione mbi lehtësimin, vizitoni faqen e internetit të Departamentit të Edukimit të Ohajos në: education.ohio.gov dhe kërkoni për **facilitation (lehtësimi)**.

Për të kërkuar lehtësimin

Kontakttoni me drejtorin e edukimit special të distriktit të shkollës tuaj për të parë nëse distrikti është i gatshëm të jetë pjesëmarrës në këtë proces, _____ në _____.

Pasi të dyja palët të pranojnë të marrin pjesë në lehtësim, kontaktoni me Zyrën për fëmijët e veçantë të Departamentit të Edukimit të Ohajos:

- Me telefon: (614) 466-2650, ose pa pagesë në (877) 644-6338; ose
- Me email në: exceptionalchildren@education.ohio.gov.

Ndërmjetësimi


Ndërmjetësimi është kur prindërit dhe distrikti i shkollës pranojnë të kenë një specialist si palë të tretë neutrale që të marrë pjesë në një takim për t'i ndihmuar të arrijnë një marrëveshje për edukimin e një student me një aftësi të kufizuar ose një student që **dysohet** se ka një aftësi të kufizuar. Palë e tretë do të thotë se ky person, i quajtur po ashtu ndërmjetës, nuk mban anë dhe nuk punon apo vepron në emër të prindit apo të distriktit. Ndërmjetësimi është një mundësi zgjedhje për prindërit dhe distriktet sa herë që ka mosmarrëveshje në lidhje me edukimin special të fëmijës tuaj.

Ndërmjetësimi është falas dhe mund të kërkohet në çdo kohë

Ndërmjetësimi mund të kërkohet në çdo kohë. Pasi të kërkohet ndërmjetësimi, ju dhe distrikti i shkollës duhet të pranoni së bashku për pjesëmarrjen në proces. Nëse pranoni të dyja palët për të marrë pjesë, Zyra për fëmijët e veçantë do t'ju japë mundësitë e zgjedhjes për një ndërmjetës për drejtimin e takimit. Nëse ju dhe distrikti nuk mund të bini dakord për një ndërmjetësues, zyra OEC do të caktojë një të tillë për ju. Ndërmjetësi nuk mund t'ju tregojë se si duhet ta zgjidhni problemin në lidhje me edukimin special të fëmijës tuaj. Ndërmjetësi i ndihmon të dyja anët që të diskutojnë për shqetësimet në lidhje me fëmijën tuaj dhe të gjejnë një zgjidhje.

Nëse vendosni që të bëni një ankesë zyrtare ose të kërkoni një seancë për një proces të rregullt (shikoni faqet 17-25), Departamenti i Edukimit të Ohajos do t'ju kërkojë të vlerësoni ndërmjetësimin si një hap të parë. Nuk ka kosto për ju ose distriktin për procesin e ndërmjetësimi.





Ndërmjetësi:

- Qëndron si një palë e tretë neutrale (nuk mban anë ose nuk punon për ju apo për distriktin);
- Nuk lejohet të marrë vendime. Në vend të kësaj, ndërmjetësi ju ndihmon ju dhe distriktin e shkollës që të zgjidhni problemin në lidhje me edukimin e fëmijës tuaj;
- Bashkëpunon me ju dhe me distriktin e shkollës për të vendosur për një marrëveshje ndërmjetësimi me shkrim;
- E mban takimin e ndërmjetësimit në drejtimin e duhur dhe ndihmon që të gjithë të respektojnë procesin;
- I mban të gjithë të përqendruar te studenti dhe nevojat e studentit;
- Ndihmon për të hapur bashkëbisedimin mes jush dhe distriktit të shkollës.

Pikat kryesore për t'u kujtuar për ndërmjetësimin

- **Ndërmjetësimi është vullnetar.**
 - Prindi dhe distrikti i shkollës duhet të pranojnë së bashku që të jenë pjesë e procesit. Nëse prindi dhe distrikti pranojnë që të marrin pjesë në një ndërmjetësim, kjo nuk do të thotë se duhet të bini dakord me distriktin në takim ose të bini dakord me përfundimin e takimit.
- **Ndërmjetësimi është konfidencial.**
 - Çdo gjë e thënë gjatë ndërmjetësimit zakonisht mbetet konfidenciale (private) dhe nuk mund të përdoret më vonë, përveçse nëse zbatohet një përjashtim.
- **Çdo marrëveshje me shkrim e bërë gjatë ndërmjetësimit është në përgjithësi detyruese. Kjo do të thotë se prindi dhe distrikti i shkollës duhet të respektojnë marrëveshjen me shkrim pas marrjes së vendimit së bashku.**
 - Çdo dokument që prindi dhe distrikti nënshkruajnë për vlerësimin ose programin IEP të fëmijës tuaj ka të njëjtën peshë si dokumentet që kanë nënshkruar në çdo takim të ekipit të vlerësimit ose të programit IEP.

Për të kërkuar ndërmjetësimin

Kontaktoni me drejtorin e edukimit special të distriktit të shkollës tuaj për të parë nëse distrikti është i gatshëm të jetë pjesëmarrës në këtë proces, _____ në _____.

Pasi të dyja palët të pranojnë të marrin pjesë në ndërmjetësim, kontaktoni me Zyrën për fëmijët e veçantë të Departamentit të Edukimit të Ohajos:

- Me telefon: (614) 466-2650, ose pa pagesë në (877) 644-6338; ose
- Me email në: exceptionalchildren@education.ohio.gov.



Paraqitja e një anekese shtetërore

Një opsion tjetër i disponueshëm për ju, nëse jeni të shqetësuar për edukimin special të fëmijës tuaj, është të bëni një anekesë shtetërore zyrtare me shkrim kundër distriktit të shkollës ose një agjencie tjetër publike dhe ta dorëzoni këtë anekesë te Zyra për fëmijët e veçantë të Departamentit të Edukimit të Ohajos.

Nuk ka kosto për paraqitjen e një anekese shtetërore

Nuk ka kosto për paraqitjen e një anekese shtetërore. Procesi i anekesës shtetërore në përgjithësi e zgjidh problemin më shpejt se një seancë procesi të rregullt dhe ka më pak kundërshti (ose konfrontime) se një seancë për procesin e rregullt. Për të paraqitur një anekesë shtetërore, duhet të dërgoni anekesën tuaj me shkrim dhe të nënshkruar (versionin origjinal) te Zyra për fëmijët e veçantë dhe duhet të dërgoni **një kopje** të anekesës drejtpërdrejt te distrikti i shkollës.

Ankesa juaj duhet të përfshijë një deklaratë për një shkelje të pretenduar të kërkesave federale ose shtetërore për edukimin special (një shkelje të pretenduar të Ligjit të edukimit për individët me aftësi të kufizuara ose Standardet operative të Ohajos për edukimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara). Ankesa nuk është e nevojshme të përfshijë emrin ose citimin e një ligji specifik, por duhet të deklarojë një veprim ose mosveprim specifik që ka kryer distrikti që besoni se është në shkelje të një kërkesë për edukimin special. Po ashtu, ju duhet të përfshini fakte në anekesë për të mbështetur se pse mendoni se distrikti ka shkelur kërkesën për edukimin special.

Rishikimi i anekesave shtetërore

Zyra për fëmijët e veçantë do të rishikojë dhe, nëse është e nevojshme, do ta hetojë një anekesë të paraqitur si duhet dhe do të përcaktojë nëse distrikti i shkollës ka shkelur një kërkesë të edukimit special në lidhje me edukimin e fëmijës tuaj. Po ashtu, një palë e tretë (d.m.th. një person i ndryshëm nga ju ose një agjenci ose organizatë e ndryshme nga distrikti i shkollës) mund të paraqesë një anekesë shtetërore te Departamenti nëse beson se distrikti ka shkelur një kërkesë të edukimit special në lidhje me një student.

Një anekesë shtetërore mund të paraqitet te Departamenti në çdo kohë brenda **një viti** nga shkelja e pretenduar e edukimit special. Çdo anekesë që pretendon për shkelje që kanë ndodhur më shumë se një vit nga data e paraqitjes së anekesës nuk do të hetohet/zgjidhet.

Si të bëni një anekesë zyrtare shtetërore

Nëse dëshironi të bëni një anekesë zyrtare shtetërore në lidhje me edukimin special, duhet që:

- Të plotësoni [formularin e anekesës shtetërore](#) dhe ta dërgoni atë te Zyra për fëmijët e veçantë të Departamentit të Edukimit të Ohajos; ose
- Të shkruani një letër anekese; ose
- Të telefononi personelin e Zyrës për fëmijët e veçantë të departamentit në numrin 1-877-644-6338 dhe të kërkonin një formular anekese, të cilin do ta plotësoni dhe do ta dërgoni përsëri te Departamenti.



Ku ta dërgoni ankesën tuaj

Ankesa juaj duhet të dërgohet te **të dyja palët**, Zyra për fëmijët e veçantë e Departamentit të Edukimit të Ohajos dhe te kryeinspektori i distriktit të shkollës në të njëjtën kohë.

Dërgoni ankesën origjinale tek:

Departamenti i Arsimit i Ohajos

Zyra për Fëmijët e Veçantë

Në vëmendje të: Asistent Drejtor i Seksionit për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve
25 South Front Street

Mail Stop 409

Kolumbi, Ohajo 43215-4183

Pezullimi

Pezullimi do të thotë vendosje në pritje të çështjeve në ankesën shtetërore. Nëse ju dhe distrikti i shkollës jeni të përfshirë në një seancë procesi të rregullt dhe ju ose distrikti paraqitni po ashtu një ankesë shtetërore për të njëjtat çështje, Departamenti i Edukimit të Ohajos do ta vendosë në pritje ankesën shtetërore. Me fjalë të tjera, Departamenti do të presë deri sa të përfundojë procesi i rregullt para se të zgjidhë ankesën tuaj shtetërore. Nëse e tërhiqni kërkesën tuaj për seancën e procesit të rregullt, Departamenti do të anulohet pezullimin e ankesës shtetërore dhe do të vazhdojë me zgjidhjen e ankesës tuaj.

Nëse zhvillohet një seancë e procesit të rregullt dhe është marrë një vendim nga oficeri i paanshëm i seancës (IHO), atëherë Departamenti do të anulohet pezullimin e ankesës shtetërore për ta zgjidhur atë vetëm nëse ka ende çështje në ankesën tuaj për të cilat nuk është marrë një vendim nga oficeri i seancës.



Lista e kontrollit që duhet të përfshini në një ankesë shtetërore

- Një deklaratë që distrikti i shkollës ka shkëlur një kërkesë federale ose shtetërore për edukimin special.
- Një përshkrim të problemit, duke përfshirë fakte ku e bazoni ankesën tuaj.
- Informacionet tuaja të kontaktit dhe nënshkrimin origjinal.
- Nëse pretendoni një shkelje të edukimit special në lidhje me një student specifik:
 - Emrin dhe adresën e banimit për studentin;
 - Emrin e shkollës që ndjek studentin;
 - Në rastin e një fëmije ose të riu të pastrehë (siç përcaktohet nga Ligji për ndihmën për të pastrehët McKinney-Vento), informacionet e disponueshme të kontaktit për studentin dhe emrin e shkollës që ndjek studentin;
 - Një përshkrim të natyrës së problemit, duke përfshirë fakte në lidhje me problemin; dhe
 - Një zgjidhje të propozuar për problemin për sa është e njohur dhe e disponueshme për palën në kohën e paraqitjes së ankesës.
- Ankesa duhet të ketë nënshkrimin origjinal, kështu që nuk mund ta dërgoni me faks ose me email ankesën tuaj.
- Ankesat anonime nuk do të pranohen.

Procesi i ankesës shtetërore

Kur Departamenti të marrë ankesën tuaj shtetërore, për sa kohë që është dorëzuar si duhet, ai do të fillojë me rishikimin e saj dhe nëse është e nevojshme do të hetojë shkeljen(t) e pretenduar për kërkesat e edukimit special. Zyra për fëmijët e veçantë duhet ta zgjidhë ankesën brenda 60 ditëve kalendarike nga data që merr ankesën tuaj.

Si pjesë e procesit të ankesës, Zyra për fëmijët e veçantë:

- Do të rishikojë ankesën tuaj dhe do të vendosë nëse ka autoritetin për zgjidhjen e pretendimeve në ankesën tuaj;
- Do t'ju informojë me shkrim ju dhe distriktin e shkollës për pretendimet që do të zgjidhë, duke përfshirë një hetim (nëse është i nevojshëm);
- Do të ofrojë ndërmjetësim dhe lehtësim për ju dhe distriktin si një mënyrë alternative për zgjidhjen e ankesës;
- Do të kërkojë më shumë informacione, që mund të jenë të nevojshme, nga ju dhe distrikti për pretendimet në ankesën tuaj;
- Do të rishikojë dokumentet dhe informacionet shtesë të dhëna nga ju dhe distrikti, do të kryejë intervista telefonike dhe do të vizitojë distriktin e fëmijës tuaj, sipas nevojës;
- Do t'i ofrojë distriktit mundësinë që t'i përgjigjet ankesës tuaj dhe të ofrojë një zgjidhje; dhe
- Do të shkruajë një letër për t'ju informuar ju dhe distriktin për vendimin e tij nëse ka pasur një shkelje të edukimit special (pas përfundimit të rishikimit të tij dhe hetimit, nëse është i nevojshëm, dhe jo më shumë se 60 ditë kalendarike nga data e marrjes së ankesës tuaj).

Zgjatjet e periudhës kohore

Departamenti mund të ketë më shumë se 60 ditë për zgjidhjen e ankesës dhe lëshimin e vendimit të tij, nëse ka një zgjatje në kohë. Një zgjatje për periudhën 60-ditore për zgjidhjen e ankesës shtetërore mund të bëhet kur:


- Ju dhe distrikti i shkollës pranoni që të keni më shumë kohë që të mund të përpiqeni ta zgjidhni problemin nëpërmjet ndërmjetësimit, lehtësimit ose disa mënyrave të tjera për zgjidhjen alternative të mosmarrëveshjes; ose kur
- Ka rrethana të veçanta (të përcaktuara nga Zyra për fëmijët e veçantë sipas rastit).

Paraqitja e papërshtatshme

Nëse Zyra për fëmijët e veçantë përcakton se nuk keni paraqitur si duhet një ankesë shtetërore pasi nuk keni përfshirë të gjitha informacionet e nevojshme për problemin që dëshironi të zgjidhni, ose nëse Zyra për fëmijët e veçantë nuk ka autoritetin për të hetuar ankesën, Zyra për fëmijët e veçantë do t'ju dërgojë një letër që shpjegon: pse nuk po vazhdon me zgjidhjen e ankesës tuaj, arsyen për këtë vendim dhe, nëse është e vlefshme, informacionet që duhet të përfshini në një ankesë të re që të konsiderohet si e paraqitur si duhet.

Ridorëzimi i ankesës

Nëse duhet ta dorëzoni përsëri ankesën me informacione të reja, sigurohuni që ta dërgoni ankesën te Departamenti i Edukimit i Ohajos dhe distrikti i shkollës brenda një viti nga koha kur ka ndodhur shkelja e pretenduar për edukim special. Nëse keni përfshirë çështje në ankesën tuaj për të cilat Departamenti nuk ka autoritetin që t'i zgjidhë, ai do t'ju rekomandojë të burimet për trajtimin e këtyre çështjeve, siç duhet.



Paraqitja e një ankese për procesin e rregullt

Një mënyrë se si prindërit mund të zgjidhin shqetësime të caktuara në lidhje me edukimin special të fëmijës së tyre me distriktin e shkollës është të paraqesin një kërkesë për një seancë procesi të rregullt drejtpërdrejt te distrikti, ndërkohë që i dërgojnë një kopje Departamentit të Edukimit të Ohajos. Kur bëni këtë, ju keni paraqitur një ankese për procesin e rregullt (e quajtur po ashtu një kërkesë për procesin e rregullt). Ka edhe të tjerë që mund të paraqesin një ankese për procesin e rregullt:

- Studenti, nëse është të paktën 18 vjeç;
- Distrikti i shkollës; ose
- Agjenci të tjera të arsimit publik.

Arsyeja për paraqitjen

Një ankese për procesin e rregullt mund të paraqitet për shqetësimet në lidhje me fushat e mëposhtme të edukimit special për fëmijën tuaj:

- Identifikimi i një fëmije me një aftësi të kufizuar;
- Vlerësimi i një fëmije me një aftësi të kufizuar;
- Caktimi i programit të edukimit për një fëmijë me një aftësi të kufizuar;
- Ofrimi i një arsimit publik falas dhe të përshtatshëm (FAPE) për fëmijën tuaj.



Ankesa për proces të rregullt duhet të pretendojë se janë shkelur kërkesat federale ose shtetërore për edukimin special dhe duhet të paraqitet brenda **dy viteve** nga data kur prindi (ose agjencia e arsimit publik që paraqet ankesën) kanë pasur njohuri ose duhet të kenë pasur njohuri për shkeljen e pretenduar në fjalë për edukimin special. Kur Departamenti i Edukimit të Ohajos të marrë një ankese për seancë të procesit të rregullt, prindërit dhe distrikti i shkollës të përfshirë duhet të kenë mundësinë të marrin pjesë në një seancë për procesin e rregullt. Seanca e procesit të rregullt është një procedurë zyrtare ku një oficer i paanshëm i seancës është caktuar nga Departamenti për zhvillimin e një seance për zgjidhjen e ankesës për procesin e rregullt.

Informacionet për t'u përfshirë

Departamenti ofron një formular që mund të përdoret për të kërkuar një seancë të procesit të rregullt. Personi ose agjencia e arsimit publik që paraqet kërkesën nuk është i detyruar të përdorë [formularin e Departamentit](#), por personi ose organizata duhet të përfshijë përsëri këto informacione të kërkuara kur paraqet një ankese për procesin e rregullt:

1. Emrin e studentit;
2. Adresën e studentit ose informacionet e kontaktit;
3. Emrin e distriktit të shkollës;
4. Nëse fëmija juaj është i pastrehë, informacionet e disponueshme të kontaktit për fëmijën tuaj dhe emrin e shkollës që ndjek fëmija juaj;
5. Një përshkrim të problemit specifik në lidhje me fëmijën tuaj, si dhe fakte për problemin; dhe
6. Ide ose sugjerime për zgjidhjen e problemit.

Ankesa për proces të rregullt duhet të përfshijë të njëjtat informacione të detajuara si një ankese shtetërore (shikoni faqen 18), sidoqoftë nuk kërkohet një nënshkrim origjinal. Ajo mund të dërgohet te distrikti i shkollës dhe Departamenti personalisht, me postë, faks ose email. Çështjet që nuk janë përfshirë në ankesën tuaj origjinale për proces të rregullt nuk do të rishikohen nga oficeri i seancës gjatë seancës së procesit të rregullt.

Ndryshimi i një ankese për procesin e rregullt

Ndryshimi i një ankese për procesin e rregullt është përditësimi i ankesës pasi ta keni paraqitur tashmë te Departamenti i Edukimit i Ohajos. Mund ta ndryshoni ankesën tuaj për procesin e rregullt vetëm nëse:

- Pala tjetër pranon ankesën e ndryshuar për procesin e rregullt, me shkrim, dhe i është dhënë mundësia për ta zgjidhur ankesën nëpërmjet një takimi për zgjidhjen (takimi për zgjidhje përshkruhet në faqen 23); ose
- Oficeri i paanshëm i seancës ju jep leje. Oficeri i seancës mund të japë një leje të tillë deri në pesë ditë para se të fillojë një seancë për procesin e rregullt, por jo më vonë.

Proçesi dhe periudhat për procesin e rregullt

Nëse paraqitni një ankesë për procesin e rregullt kundër distriktit të shkollës së fëmijës tuaj, brenda 10 ditëve kalendarike nga marrja e ankesës për procesin e rregullt, distrikti duhet t'ju japë një njoftim paraprak me shkrim ose një përgjigje në lidhje me shkeljen e pretenduar për edukimin special, përveçse nëse distrikti e ka dhënë tashmë një njoftim të tillë (shikoni faqen 9). Njoftimi paraprak me shkrim që ju jep distrikti duhet të përfshijë:

- Një përshkrim të veprimit me të cilin ka lidhje kërkesa ose ankesa juaj. Ky mund të jetë një veprim që distrikti ka kërkuar të kryejë ose një veprim që ka refuzuar ta kryejë. Distrikti duhet të shpjegojë po ashtu në përgjigjen e tij se pse shkolla dëshironte të kryente veprimin ose ka refuzuar ta kryejë veprimin;
- Një përshkrim të të gjitha metodave që ka përdorur për të vlerësuar fëmijën tuaj, regjistrimet për fëmijën tuaj dhe raportet që distrikti ka përdorur për të marrë vendimin e tij për kryerjen ose moskryerjen e veprimit;
- Një përshkrim të mundësive të tjera të zgjedhjes që ekipi i programit IEP ka marrë në konsideratë për fëmijën tuaj dhe arsyen(t) pse i ka refuzuar këto zgjedhje; dhe
- Një përshkrim të faktorëve të tjerë që kanë pasur lidhje me vendimin e distriktit për kryerjen ose moskryerjen e veprimit.

Distrikti i shkollës duhet t'ju japë po ashtu informacione për ndihmën ligjore falas ose me kosto të ulët dhe shërbime të tjera përkatëse që mund të merrni.

Nëse paraqitet një ankesë për procesin e rregullt kundër jush si prind, ju duhet t'i përgjigjeni ankesës brenda 10 ditëve kalendarike. Përgjigja juaj duhet të trajtojë në mënyrë specifike çështjet e ngritura në ankesën për procesin e rregullt.

Mjaftueshmëria

Ankesa për procesin e rregullt do të konsiderohet si e mjaftueshme (që do të thotë se është dorëzuar si duhet) **përveçse** nëse pala tjetër njofton oficerin e paanshëm të seancës dhe palën që ka dorëzuar ankesën me pretendimin se ankesa nuk i plotëson kërkesat për paraqitjen e saj (d.m.th. nuk është e mjaftueshme). Pala tjetër duhet ta kundërshtojë mjaftueshmërinë e ankesës për procesin e rregullt, me shkrim, brenda 15 ditëve kalendarike nga marrja e ankesës për procesin e rregullt.

Për shembull, nëse paraqitni një ankesë për procesin e rregullt te distrikti juaj (dhe dërgoni kopje te Departamenti i Edukimit i Ohajos), ajo do të konsiderohet si e mjaftueshme përveçse nëse distrikti njofton oficerin e seancës, me shkrim dhe brenda 15 ditëve, se nuk mendon se kërkesa juaj është paraqitur si duhet. Më pas, oficeri i seancës ka pesë ditë kalendarike nga marrja e njoftimit me shkrim të distriktit për të vendosur nëse ankesa juaj për procesin e rregullt është e mjaftueshme (që i plotëson kërkesat për ankesën për procesin e rregullt siç janë identifikuar në faqen 21). Oficeri i seancës duhet t'ju dërgojë po ashtu juve dhe distriktit vendimin e tij, me shkrim, brenda 15 ditëve.

Nëse oficeri i seancës vendos se ankesa juaj për procesin e rregullt është e pamjaftueshme, ju keni mundësinë të paraqitni përsëri një ankesë të re për procesin e rregullt ose të ndryshoni ankesën origjinale për procesin e rregullt, për sa kohë që distrikti e pranon këtë dhe ka mundësinë ta zgjidhë situatën nëpërmjet një takimi për zgjidhjen ose oficeri i seancës jep lejen e tij jo më vonë se pesë ditë para fillimit të seancës.

Nëse e ndryshoni si duhet ankesën tuaj për procesin e rregullt, atëherë periudha 30-ditore për zgjidhjen (shikoni faqen 23) fillon kur të paraqitni ankesën e ndryshuar.

Periudha e zgjidhjes

Periudha e zgjidhjes është periudha kohore nga paraqitja e një ankese për procesin e rregullt deri në seancën aktuale për procesin e rregullt. Periudha e zgjidhjes përfshin një takim për zgjidhjen që ofron një mundësi, edhe një herë tjetër, për ta zgjidhur mosmarrëveshjen për edukimin special para fillimit zyrtar të seancës. Nëse paraqitni një ankesë për procesin e rregullt, por më pas nuk arrini të merrni pjesë në procesin e zgjidhjes, kjo do të vonojë nisjen e periudhave për procesin e rregullt (më shumë për periudhat më poshtë).

Periudha e zgjidhjes është 30 ditë nga data kur është paraqitur ankesa për procesin e rregullt (ose nga data kur ankesa është ndryshuar si duhet). Nëse distrikti i shkollës nuk e ka zgjidhur ankesën për procesin e rregullt në mënyrë të pranueshme për ju deri në 30 ditë, mund të vazhdojë seanca për procesin e rregullt. Pas përfundimit të periudhës 30-ditore të zgjidhjes, është një periudhë 45-ditore për seancën për procesin e rregullt dhe për marrjen e një vendimi nga oficeri i paanshëm i seancës (shikoni faqen 24), përveçse nëse ju dhe distrikti keni rënë dakord për një ndërmjetësim që i kalon 30 ditët. Kini parasysh po ashtu se periudha 30-ditore e zgjidhjes mund të përfundojë më herët nëse, gjatë atyre 30 ditëve, ju dhe distrikti pranoni me shkrim se nuk mund të arrihet një marrëveshje.

Gjatë periudhës 30-ditore të zgjidhjes dhe brenda 15 ditëve të para kalendarike nga marrja e ankesës për procesin e rregullt, distrikti i shkollës duhet të planifikojë një takim për zgjidhjen. Nëse distrikti nuk zhvillon një takim për zgjidhjen brenda 15 ditëve kalendarike ose nuk merr pjesë në takimin për zgjidhjen, mund të kërkoni që oficeri i seancës të fillojë periudhën 45-ditore të seancës për procesin e rregullt. Nuk kërkohet që distrikti të planifikojë një takim për zgjidhjen nëse ka paraqitur ankesën për procesin e rregullt.

Takimi për zgjidhje

Qëllimi i takimit për zgjidhje është t'ju japë një mundësi të diskutoni për problemet në ankesë dhe që distrikti i shkollës të ketë mundësinë të bashkëpunojë me ju për të gjetur një zgjidhje. Është përgjegjësia e distriktit që të organizojë takimin për zgjidhjen, dhe ju duhet të merrni pjesë. Nëse nuk merrni pjesë në takimin për zgjidhje dhe distrikti dokumenton mungesën e pjesëmarrjes tuaj, distrikti mund t'i kërkojë oficerit të seancës që ta anulojë ankesën tuaj për procesin e rregullt në fund të periudhës 30-ditore.

Ju dhe distrikti i shkollës vendosni se cilët anëtarë të ekipit të programit IEP duhet të marrin pjesë në takimin për zgjidhjen. Ky takim duhet të përfshijë përfaqësuesin e distriktit të shkollës që ka autoritetin për të marrë vendime për distriktin.

Avokati i distriktit nuk do të marrë pjesë në këtë takim, përveçse nëse zgjidhni që të keni avokatin tuaj aty. Ky takim është një hap i domosdoshëm në procesin e zgjidhjes, përveçse nëse ju dhe distrikti pranoni me shkrim që të hiqni dorë nga takimi për zgjidhjen ose ju dhe distrikti pranoni të përdorni ndërmjetësimin në vend të takimit për zgjidhje. Ju dhe distrikti lejoheni që të kërkoni një ndërmjetësim pas periudhës 30-ditore të zgjidhjes nëse të dyja palët bini dakord për këtë gjë. Kjo do të pengojë fillimin e periudhës 45-ditore për seancën për procesin e rregullt dhe vendimin përkatës.

Nëse ju dhe distrikti e zgjidhni mosmarrëveshjen tuaj në takimin për zgjidhjen, të dyja palët duhet të nënshkruani një marrëveshje ligjërishit detyruese që:

- Përcakton se çfarë do të ndodhë tani, me shkrim;
- Është e nënshkruar nga ju dhe një përfaqësues i distriktit; dhe
- Zbatimi i saj mund të detyrohet nga një gjykatë.

Ligjërishit detyruese do të thotë se nëse ju ose distrikti i shkollës nuk e respektoni marrëveshjen, një gjykatë mund të kërkojë që ju ose distrikti ta respektoni atë.

Nëse ju ose distrikti vendosni që të mos e pranoni, pas nënshkrimit të marrëveshjes, secila palë prej jush mund ta anulojë marrëveshjen brenda tre ditësh pune nga nënshkrimi i saj.

Nëse ju dhe distrikti i shkollës keni arritur një marrëveshje për ankesën për procesin e rregullt para përfundimit të periudhës 30-ditore të zgjidhjes, ankesa do të mbyllet dhe nuk do të zhvillohet një seancë për procesin e rregullt.

Proçesi i seancës

Një seancë për procesin e rregullt duhet të planifikohet dhe të zhvillohet në një vend dhe kohë që janë të përshtatshme dhe të pranueshme për ju dhe distriktin e shkollës. Oficeri i paanshëm i seancës do të kontaktojë me ju dhe distriktin në të njëjtën kohë kur të ketë nevojë për të komunikuar gjatë procesit të seancës. Me fjalë të tjera, të gjitha kontaktet mes oficerit të paanshëm të seancës, juve dhe distriktit do të kryhen së bashku dhe jo të ndara.

Periodha 45-ditore e seancës për procesin e rregullt (dhe për marrjen e vendimit nga oficeri i paanshëm i seancës) fillon pas përfundimit të periudhës 30-ditore të zgjidhjes ose pasi të ndodhë një nga këto:

- Ju dhe distrikti pranoni me shkrim që të hiqni dorë (të mos zhvilloni) nga takimi për zgjidhjen; ose
- Pasi filloni të diskutoni për çështjet në një takim për zgjidhjen ose takim ndërmjetësimi, ju dhe distrikti pranoni me shkrim se nuk mund të arrihet një marrëveshje; ose
- Ju dhe distrikti pranoni me shkrim ta kaloni periudhën 30-ditore të zgjidhjes që të mund të vazhdoni me ndërmjetësimin, dhe më pas ju ose distrikti tërhiqeni nga procesi i ndërmjetësimit.

Përveçse kur oficeri i paanshëm i seancës pranon të japë më shumë kohë (ose me fjalë të tjera të japë një zgjatje afati), me kërkesën e një nga palët brenda periudhës 45-ditore të seancës, do të zhvillohen sa më poshtë:

- Seanca duhet të zhvillohet;
- Duhet të arrihet një vendim i seancës; dhe
- Një kopje e veprimit duhet të dërgohet me postë të certifikuar te ju dhe distrikti i shkollës, si dhe te Departamenti i Edukimit i Ohajos.

Të paktën pesë ditë para seancës për procesin e rregullt, ju dhe distrikti i shkollës duhet të merrni pjesë në një konferencë prezantuese. Ky është një bashkëbisedim për të siguruar që ju dhe distrikti keni informacionet që do të prezantohen në seancë.



Seancat për procesin e rregullt zhvillohen nga një oficer i paanshëm i seancës

Kur një ankesë për procesin e rregullt nuk mund të zgjidhet, ajo do të vazhdojë me një seancë zyrtare të zhvilluar nga një oficer i paanshëm i seancës. Oficeri i seancës duhet të jetë një avokat që është trajnuar nga Departamenti i Edukimit i Ohajos për zhvillimin e seancave për procesin e rregullt.

Distrikti i shkollës paguan koston për oficerin e seancës, sidoqoftë ky individ është një palë e tretë neutrale.

Ai ose ajo nuk është i punësuar nga distrikti i shkollës ose një agjenci tjetër publike e përfshirë në edukim dhe nuk mund të ketë një interes personal ose profesional që do të favorizonte një palë ndaj një tjetre.

Përveç kësaj, oficeri i seancës është i njohur mirë me kërkesat e edukimit special, duke përfshirë ligjin IDEA, ligjet dhe rregulloret federale dhe shtetërore dhe se si interpretohen nga gjykatat çështjet e edukimit special.

Pas seancës, oficeri i seancës do të marrë një vendim me shkrim sipas praktikës ligjore standarde. Distrikti juaj ose Departamenti i Edukimit i Ohajos mund të ofrojë një listë të oficerëve të seancave dhe kualifikimeve të tyre, ose mund ta gjeni listën duke vizituar education.ohio.gov dhe të kërkonti me fjalët kyçe *oficerët e seancave për procesin e rregullt ligjor*.

Të drejtat për seancën

Në një seancë për procesin e rregullt, ju keni të drejtën që:

- Të jetë i pranishëm fëmija juaj që është objekt i seancës;
- Të kërkonti që seanca të jetë e hapur për publikun;
- Të shoqëroheni dhe të këshilloheni nga avokati juaj ose persona me njohuri të veçanta për fëmijët me aftësi të kufizuara;
- Të paraqitni dëshmi (prova), të ballafaqoheni dhe t'u bëni pyetje dëshmitarëve dhe të kërkonti praninë e dëshmitarëve (përsëri, seanca do të trajtojë vetëm çështjet që keni ngritur në ankesën tuaj për procesin e rregullt, përveçse nëse distrikti pranon t'ju lejojë të ngrini çështje të reja);
- Të ndaloni çdo dëshmi të paraqitur që nuk ju është treguar të paktën pesë ditë pune para seancës; dhe
- Pa kosto për ju, të merrni një regjistrim fjalë-për-fjalë me shkrim, ose nëse preferoni elektronik, për çdo regjistrim të përfundimeve dhe vendimeve.

Nëse shoqëroheni nga një këshilltar që nuk është avokat

Nëse shoqëroheni nga një këshilltar që nuk është avokat, këta individë nuk kanë të drejtë të marrin tarifa si avokat (ose çdo tarifë tjetër për shërbimet e tyre) nga asnjë palë. Këshilltari nuk mund të kryejë një praktikë ligjore gjatë seancës dhe përfshirja e tij mund të jetë e kufizuar gjatë procedurës.

Ankesat e përshpejtuara për procesin e rregullt dhe periudha kohore

Një seancë e përshpejtuar për procesin e rregullt është një seancë me periudha kohore më të shpejta që ndihmon për një zgjidhje më të shpejtë të mosmarrëveshjeve të caktuara për edukimin special. Ju ose distrikti mund të paraqitni një kërkesë për një seancë të përshpejtuar për procesin e rregullt në këto situata vetëm nëse:

1. Ju nuk jeni dakord me vendimin e distriktit të shkollës për caktimin e programit të edukimit për fëmijën tuaj (programi ose shërbimet), dhe kjo ka qenë rezultat i masës disiplinore të shkollës për fëmijën tuaj; ose
2. Ju nuk jeni dakord me rezultatet e një vendimi për manifestimin; ose
3. Distrikti i shkollës beson se caktimi aktual i programit të edukimit për fëmijën tuaj (programi ose shërbimet) ka shumë mundësi të sjellë si rezultat lëndime për fëmijën tuaj ose të tjerët.

Periudha për ankesën e përshpejtuar për procesin e rregullt përfshin një periudhë të zgjidhjes me 15 ditë kalendarike dhe një periudhë për seancën me 20 ditë shkollore. Distrikti i shkollës duhet të planifikojë një takim për zgjidhjen brenda shtatë ditësh kalendarike nga marrja e një ankese për procesin e rregullt. Pas përfundimit të seancës së përshpejtuar për procesin e rregullt, oficeri i seancës ka 10 ditë shkollore për një vendim përfundimtar me shkrim dhe paraqitjen e vendimit për ju dhe distriktin. Nuk do të jepet më shumë kohë gjatë një ankese të përshpejtuar për procesin e rregullt.



Apelimi i një vendimi

Vendimi i marrë nga oficeri i paanshëm i seancës në përfundim të seancës për procesin e rregullt është përfundimtar, përveçse nëse pala e pakënaqur paraqet një apel drejtpërdrejt te Departamenti i Edukimit i Ohajos brenda 45 ditëve nga marrja e vendimit. Një palë e pakënaqur është prindi ose distrikti kur vendimi i oficerit të seancës nuk është i favorshëm për këtë palë (që do të thotë se pala nuk ka fituar).

Si të apelon vendimet e oficerit të seancës

Për të apeluar vendimin e oficerit të seancës, duhet të dërgoni një kopje të apelimit tuaj me shkrim te Departamenti dhe një kopje të apelimit te kryeinspektori i distriktit të shkollës tuaj. Departamenti do të caktojë një oficer për rishikimin në nivel shtetëror (oficeri i rishikimit) për kryerjen e një rishikimi të paanshëm mbi vendimin për procesin e rregullt. Departamenti i Edukimit i Ohajos do të paguajë për oficerin e rishikimit. Oficeri i rishikimit do të ekzaminojë regjistrimet për të gjithë seancën për procesin e rregullt. Përveç kësaj, oficeri i rishikimi do të sigurohet që seanca ka respektuar kërkesat për procesin e rregullt dhe do të kërkojë prova shtesë sipas nevojës. Oficeri i rishikimit mund të kërkojë argumente verbale ose me shkrim nga ju dhe distrikti i shkollës. Nëse oficeri i rishikimit zhvillon një seancë për të marrë në konsideratë argumentet verbale, të gjitha të drejtat për seancën (shikoni faqen 25) që ju ofrohen në një seancë për procesin e rregullt ju ofrohen po ashtu gjatë seancës.

Për të kërkuar një apelim për vendimin e oficerit të paanshëm të seancës

Mund ta kundërshtoni vendimin e oficerit të paanshëm të seancës (të apelon) me shkrim brenda 45 ditëve kalendarike nga marrja e vendimit. Dërgoni apelimin tuaj te:

Departamenti i Arsimit i Ohajos
Zyra për Fëmijët e Veçantë
Seksioni i Zgjidhjes së Ankesave
25 South Front Street
Mail Stop 409
Kolumbi, Ohajo 43215

Për më shumë ndihmë, telefononi në Zyrën për fëmijët e veçantë të Departamentit të Edukimit të Ohajos në numrin (614) 466-2650, ose pa pagesë në (877) 644-6338.

Periudhat kohore/zgjatjet

Brenda 30 ditëve pasi Departamenti të marrë kërkesën tuaj për një rishikim në nivel shtetëror, oficeri i rishikimit do të japë një vendim, përveçse kur ai ose ajo lejon një zgjatje në kohë, e cila mund të kërkohet nga prindi ose nga distrikti (sidoqoftë, kini parasysh se zgjatjet në kohë nuk mund të jepen gjatë një apelimi nga një seancë e përshpejtuar për procesin e rregullt). Mund të kërkonte po ashtu kopje elektronike ose me shkrim ose regjistrime elektronike fjalë-për-fjalë të përfundimeve dhe vendimit të oficerit të rishikimit.

Apelimi në një gjykatë federale ose shtetërore

Vendimi i rishikimit në nivel shtetëror është përfundimtar, përveçse nëse apelohe në një gjykatë federale ose shtetërore. Pala e pakënaqur (që nuk ka fituar) nga vendimi i oficerit të rishikimit ka të drejtën të paraqesë një padi në një gjykatë federale të distriktit brenda 90 ditëve nga data e vendimit të oficerit të rishikimit ose në gjykatën civile të kontesë ku ndodhet distrikti i shkollës së fëmijës tuaj brenda 45 ditëve nga marrja e njoftimit për vendimin e oficerit të rishikimit. Gjykata do të rishikojë regjistrimet, do të dëgjojë më shumë dëshmi sipas kërkesës së palëve dhe më pas do të marrë një vendim përfundimtar bazuar në regjistrimet dhe dëshmitë e paraqitura. Ju duhet të paguani kostot gjyqësore për një apelim që paraqitni në gjykatë por, nëse fitoni, mund të keni të drejtën për mbulimin e tarifave të gjykatës dhe të avokatit (shikoni faqen 28) sipas zgjedhjes së gjykatës.

Statusi i fëmijës gjatë procesit të rregullt

- Fëmija juaj duhet të qëndrojë ose të mos lëvizë nga caktimi aktual i programit të edukimit ndërkohë që një ankesë për procesin e rregullt është në vazhdim, përveçse nëse ju dhe distrikti i shkollës pranoni që programi i caktuar i edukimit për fëmijën tuaj mund të ndryshohet.
- Programi i caktuar i edukimit për fëmijën tuaj është ai që përshkruhet në programin IEP të zbatuar së fundi për të.
- Nëse fëmija juaj është caktuar në një kuadër të përkohshëm alternativ të edukimit (IAES - një kuadër i përkohshëm mësimor jashtë shkollës) për shkak të disiplinimit nga distrikti i shkollës, fëmija juaj do të qëndrojë në atë kuadër edukimi deri sa oficeri i seancës të marrë një vendim ose deri sa të përfundojë masa disiplinore e distriktit për fëmijën tuaj, cila të ndodhë më parë;
- Nëse ankesa për procesin e rregullt përfshin pranimin te distrikti, fëmija juaj, me lejen tuaj, duhet të caktohet te distrikti deri sa të përfundojë procesi i rregullt.
- Nëse kërkesa për procesin e rregullt përfshin aplikimin për të filluar shërbimet sipas pjesës së ligjit për moshën shkollore për shkak se fëmija juaj ka mbushur 3 vjeç dhe nuk është më i përshtatshëm për shërbimet sipas pjesës së ligjit për ndërhyrje të hershme, distrikti i shkollës nuk është e detyruar të ofrojë shërbimet e ndërhyrjes së hershme që nuk janë marrë nga fëmija juaj.
- Nëse arrihet në përfundimin se fëmija juaj është i përshtatshëm për shërbimet e edukimit special dhe prindi jep pëlqimin për ofrimin fillestar të shërbimeve, atëherë distrikti i shkollës duhet t'i ofrojë ato shërbime që nuk janë pjesë e mosmarrëveshjes mes prindit dhe distriktit.
- Nëse oficeri i rishikimit është dakord me prindërit e fëmijës për një ndryshim të caktimit të programit të edukimit si të përshtatshëm, caktimi i programit të edukimit duket të trajtohet si një marrëveshje mes shtetit dhe prindërve për qëllimet e moslëvizjes.

Tarifat e avokatit

Mund të zgjidhni që të kontraktoni një avokat në çdo kohë për t'ju përfaqësuar ju gjatë procesit të rregullt (ose procedurave për apelimin e një vendimi për procesin e rregullt), por ju duhet t'i paguani vetë kostot tuaja ligjore. Nëse zgjidhni të kontraktoni një avokat dhe fitoni (merrni një vendim të favorshëm) në çdo veprim ose procedurë në lidhje me seancën për procesin e rregullt (duke bërë që të jeni pala fituese), gjykata mund të urdhërojë që distrikti t'ju paguajë tarifa të arsyeshme për avokatin.

Nëse fiton distrikti

Nëse fiton distrikti, gjykata mund t'ju urdhërojë që t'i paguani distriktit tarifa të arsyeshme për avokatin. Gjukata mund t'ju urdhërojë ju ose avokatin tuaj që të paguani tarifat e avokatit të Departamentit të Edukimit të Ohajos ose të distriktit të shkollës nëse ata fitojnë dhe gjykata vendos një nga sa më poshtë:

- Se veprimi ligjor ishte i pavlerë, i paarsyeshëm ose pa baza;
- Se keni vazhduar të paraqitni veprime ligjore të njëpasnjëshme që qartësisht janë bërë të pavlera, të paarsyeshme ose pa baza; ose
- Se veprimi ligjor është paraqitur për një qëllim të papërshtatshëm, si p.sh. për të sulmuar, për të shkaktuar vonesa të panevojshme ose për të rritur kostot ligjore pa qenë e nevojshme.

Nëse gjykata urdhëron që tarifat ligjore të ripaguhet për ju ose për distriktin

Nëse gjykata urdhëron që tarifat ligjore të ripaguhet për ju ose për distriktin, gjykata do të vendosë shumën e arsyeshme për këtë. Tarifat e avokatit duhet të bazohen në çmimet e zakonshme në komunitetin ku është kryer veprimi ligjor ose procedura, si dhe në llojin dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara. Ka disa kufizime të caktuara në aftësinë e gjykatës për të njohur tarifat e avokatit. Një gjykatë nuk mund të njohë tarifat e avokatit në këto raste:

- Kur distrikti bën një ofertë me shkrim për zgjidhjen e mos marrëveshjes brënda 10 ditëve nga procedura, ju nuk e pranoni ofertën brenda 10 ditëve dhe vendimi në këtë çështje është më pak i favorshëm për ju se zgjidhja e propozuar në ofertën e distriktit;
 - Sidoqoftë, një gjykatë mund të njohë tarifat për ju nëse ju fitoni në veprimin ligjor dhe gjykata vendos se keni justifikime të konsiderueshme (keni pasur arsye të fortë) për të mos pranuar ofertën për zgjidhje nga distrikti;
- Për pjesëmarrjen e avokatit tuaj në një takim të programit IEP, përveçse nëse ai takim është thirrur si rezultat i një seance administrative ose veprimi gjyqësor; dhe
- Për pjesëmarrjen e avokatit tuaj në një takim për zgjidhjen.

Ulja e tarifave të avokatit

Gjukata mund të zvogëlojë tarifat e njohura të avokatit nëse:

- Gjatë procedurave, ju ose avokati juaj keni vonuar pa arsye zgjidhjen përfundimtare të mosmarrëveshjes;
- Shuma e tarifave të avokatit është shumë më e lartë se tarifa aktuale për orë në komunitet për shërbime të ngjashme nga avokatët me aftësi, reputacion dhe eksperiencë të krahasueshme dhe të pranueshme;
- Koha e harxhuar dhe shërbimet ligjore të marra nga ju kanë qenë të tepërta duke pasur parasysh natyrën e veprimit ligjor ose të procedurës;
- Avokati juaj nuk ka dhënë informacione të përshtatshme për distriktin e shkollës në njoftimin e ankesës.

Asnjë nga sa më sipër nuk është e vlefshme nëse gjykata del në përfundimin se shteti ose distrikti i shkollës kanë vonuar pa arsye vendimin përfundimtar për veprimin ligjor ose procedurën ose kanë shkelur në një mënyrë tjetër masat procedurale të ligjit IDEA.

Në disa raste, distrikti i shkollës mund të duhet të vazhdojë ofrimin e shërbimeve të edukimit special për fëmijën tuaj me aftësi të kufizuara, edhe pasi distrikti të ketë pezulluar, përjashtuar ose larguar në një mënyrë tjetër fëmijën tuaj nga caktimi aktual i programit të edukimit për të (referojuni programit IEP për fëmijën tuaj për më shumë informacione në lidhje me caktimin aktual të programit të edukimit për të).

Caktimi i programit të edukimit dhe alternativat

Nëse fëmija juaj largohet nga programi aktual i caktuar i edukimit për shkak të shkeljes së rregullave të distriktit të shkollës për më pak se 10 ditë shkollore në vazhdim, distrikti nuk është i detyruar të ofrojë shërbime të edukimit special për fëmijën tuaj gjatë kësaj kohe. Nëse fëmija juaj largohet nga shkolla *për më shumë se 10 ditë shkollore në vazhdim*, shkolla duhet të vazhdojë të ofrojë shërbimet e edukimit special për fëmijën tuaj, edhe nëse është në një kuadër tjetër arsimor (për shembull, në një klasë tjetër, një ndërtesë tjetër ose në shtëpinë e studentit).

Nëse distrikti i shkollës e largon fëmijën tuaj nga programi aktual i caktuar i edukimit për të për më shumë se 10 ditë shkollore në vazhdim në të njëjtin vit shkolror, kjo konsiderohet një ndryshim i programit të caktuar të edukimit për fëmijën tuaj.

Nëse distrikti i shkollës e ka larguar fëmijën tuaj nga programi aktual i caktuar i edukimit për të në raste të veçanta (një seri largimesh) që bëjnë më shumë se 10 ditë në një vit shkolror, distrikti duhet të përcaktojë nëse ato largime përbëjnë një ndryshim të programit të caktuar të edukimit për fëmijën tuaj. Për të përcaktuar këtë, distrikti duhet të marrë në konsideratë faktorët e mëposhtëm:

- Për sa kohë është larguar fëmija juaj;
- Kohën në total kur është larguar fëmija juaj;
- Sa afër kanë qenë largimet me njëri-tjetrin; dhe
- Ngjashmëria e sjelljeve të fëmijës tuaj me incidentet e mëparshme kur fëmija juaj është larguar.

Kur ndryshohet programi i caktuar i edukimit për një fëmijë për shkak se fëmija juaj nuk ka respektuar rregullat e shkollës, distrikti i shkollës, prindi ose anëtarët përkatës të ekipit të programit IEP duhet të takohen për të zhvilluar një rishikim të përcaktimit për manifestimin. Qëllimi i rishikimit të përcaktimit për manifestimin është të përcaktohet nëse sjellja e fëmijës tuaj është shkakuar ose ka pasur një lidhje të drejtpërdrejtë dhe të konsiderueshme me aftësinë e kufizuar të fëmijës tuaj.



Përcaktimi i manifestimit

Para se të ndryshohet caktimi i programit të edukimit për fëmijën tuaj për arsye disiplinore, distrikti i shkollës duhet të ndërmarrë hapa të caktuar për të mbrojtur të drejtat e fëmijës tuaj. Një hap i tillë është mbajtja e një takimi rishikimi për përcaktimin e manifestimit. Ky është një takim për të përcaktuar nëse sjellja e fëmijës tuaj është shkaktuar ose ka pasur një lidhje të drejtpërdrejtë dhe të konsiderueshme me aftësinë e kufizuar të fëmijës tuaj. Me fjalë të tjera, a është shkaktuar sjellja e fëmijës tuaj nga aftësia e tij e kufizuar? Ekipi i programit IEP për studentin do të përcaktojë nëse sjellja e fëmijës tuaj është shkaktuar apo jo nga aftësia e kufizuar brenda 10 ditëve shkollore për çdo vendim për ndryshimin e caktimit të programit të edukimit.

Kini parasysh

Fëmija juaj është objekt i të njëjtave rregulla dhe masa disiplinore si çdo student në shkollë dhe do të vazhdojë të marrë shërbimet e përshkruara në programin IEP, por ndoshta jo në të njëjtin program të caktuar.

Takimi i rishikimit për përcaktimin e manifestimit

Në takimin e rishikimit për përcaktimin e manifestimit, ju dhe anëtarët e tjerë të ekipit të programit IEP do të rishikoni informacionet përkatëse, duke përfshirë vërejtjet e programit IEP, të mësuesit të fëmijës tuaj dhe çdo informacion përkatës i dhënë.

Nëse sjellja është një manifestim i aftësisë së kufizuar të fëmijës tuaj, fëmija juaj do të rikthehet në programin e caktuar të edukimit nga ku është larguar, përveçse nëse ekipi i programit IEP pranon ndryshimin e programit të caktuar të edukimit.

Nëse arrihet në përfundimin se sjellja e fëmijës tuaj është një manifestim i aftësisë së kufizuar, ekipi i programit IEP duhet që:

1. Të fillojë një vlerësim funksional të sjelljes brenda 10 ditësh dhe ta përfundojë atë sa më shpejt të jetë e mundur. Një vlerësim funksional i sjelljes është një rishikim i sjelljes së fëmijës tuaj, i cili përdoret për të përcaktuar se çfarë e shkakton sjelljen e papërshtatshme në ambientin e fëmijës, si dhe sjelljesh duhet të mësohen për rikthimin që fëmija juaj të arrijë rezultate dhe vlerësime pozitive; dhe
2. Të fillojë një plan ndërhyrjeje për sjelljen për fëmijën tuaj nëse vlerësimi funksional i sjelljes është përfunduar tashmë dhe ka lidhje me masën disiplinore në fjalë. (Një plan ndërhyrjeje për sjelljen trajton sjelljet që nuk janë të përshtatshme për shkollën dhe mënyra specifike se si shkolla do të përpiqet t'i minimizojë ato.); ose
3. Nëse ekziston tashmë një plan ndërhyrjeje për sjelljen, të rishikojë planin dhe të bëjë çdo ndryshim të nevojshëm brenda 10 ditëve.



Kuadri i përkohshëm alternativ (i përkohshëm dhe i ndryshëm) i edukimit

Vendimi për caktimin e fëmijës tuaj në një kuadër të përkohshëm alternativ të edukimit (IAES) merret nga ekipi i programit IEP për fëmijën tuaj. Një kuadër IAES është një caktim i përkohshëm i ndryshëm i programit të edukimit për fëmijën tuaj për marrjen e edukimit special. Në datën kur ekipi i programit IEP vendos që të ndryshojë caktimin e programit për fëmijën tuaj në një kuadër IAES për shkak se fëmija juaj ka shkelur një rregull të shkollës, distrikti i shkollës duhet t'ju njoftojë për vendimin dhe t'ju ofrojë këtë Udhëzues për të drejtat e prindërve në edukimin special.

Edhe nëse sjellja e fëmijës tuaj është shkaktuar nga aftësia e kufizuar e fëmijës tuaj, distrikti mund ta largojë fëmijën tuaj në një kuadër IAES për deri në 45 ditë shkollë nëse fëmija juaj:

- Ka mbajtur një armë;
- Ka pasur në zotërim ose ka përdorur me njohuri të drogës të paligjshme, ose ka shitur ose është përpjekur të blejë ose të shesë një substancë të kontrolluar (për shembull, substanca narkotike); ose
- I ka shkaktuar lëndime të rënda trupore një personi tjetër.

Zakonisht kjo gjë zbatim pavarësisht nëse fëmija juaj e ka shfaqur sjelljen gjatë rrugës për në shkollë, në shkollë ose në një funksion shkollor.

Nëse sjellja e fëmijës tuaj **nuk është shkaktuar drejtpërdrejt nga aftësia e kufizuar e fëmijës tuaj**, fëmija juaj mund të vendoset në një kuadër IAES për të njëjtën kohë me masën disiplinore për një fëmijë pa aftësi të kufizuara.

Nëse sjellja e fëmijës tuaj **është lidhur drejtpërdrejt ose është shkaktuar nga aftësia e kufizuar e fëmijës** dhe fëmija juaj ka shkelur rregullat e shkollës, fëmija duhet të kthehet në kuadrin e edukimit nga ku është larguar, përveçse nëse ju dhe distrikti i shkollës bini dakord për një ndryshim të caktimit të programit të edukimit si pjesë e ndryshimit në planin e ndërhyrjes për sjelljen ose programit IEP.

Sidoqoftë, nëse distrikti beson se mbajtja e fëmijës tuaj në programin aktual të edukimit të caktuar për të (sipas programit IEP të fëmijës) ka shumë mundësi që të shkaktojë lëndime të fëmijës tuaj ose të tjerëve, distrikti i shkollës mund të thërrasë një takim të programit IEP për të diskutuar mbi këtë shqetësim. Nëse ju dhe distrikti nuk bini dakord për ndryshimin e programit të caktuar të edukimit, distrikti mund të kërkojë një seancë të përshpejtuar për procesin e rregullt - me fjalë të tjera, mund të kërkojë një seancë për procesin e rregullt që do të shpejtohet për një zgjidhje më të shpejtë (Shikoni seanca e përshpejtuar për procesin e rregullt në faqen 25).

Nëse nuk jeni dakord me ndryshim të programit të edukimit të caktuar ose rezultatin e seancës së rishikimit për përcaktimin e manifestimit

Mund të kërkonit një seancë të përshpejtuar për procesin e rregullt për të kundërshtuar një vendim për të ndryshuar kuadrin aktual të edukimit për fëmijën tuaj për shkak të disiplinës ose për të kundërshtuar përfundimet e një rishikimi për përcaktimin e manifestimit. (Shikoni informacionet për procesin e rregullt në faqet 24 - 25). Oficeri i paanshëm i seancës do të vendosë gjatë seancës së përshpejtuar për procesin e rregullt nëse distrikti i shkollës ka respektuar kërkesat kur ka ndryshuar programin e caktuar të edukimit për fëmijën ose nëse distrikti ka treguar se sjellja e fëmijës tuaj ka qenë ose nuk ka qenë një manifestim i aftësisë së kufizuar të fëmijës.

Siç thuhet më sipër, distrikti i shkollës mund të kërkojë një seancë të përshpejtuar për procesin e rregullt nëse distrikti beson se vazhdimi i programit të caktuar të edukimit i fëmijës tuaj ka shumë mundësi të shkaktojë lëndime për fëmijën tuaj ose të tjerët. (Shikoni seancën e përshpejtuar për procesin e rregullt në faqen 25).

Kur sjellja e fëmijës tuaj është për shkak të një aftësie të kufizuar të dyshuar

Nëse fëmija juaj nuk ka një program IEP, mund t'ju kërkonit shkollës që ta trajtojë fëmijën si një fëmijë me aftësi të kufizuara në rast se para se fëmija të shkelte një rregull të shkollës ka ndodhur një nga këto gjëra:

- Keni informuar drejtuesit e shkollës ose mësuesin e fëmijës tuaj, me shkrim, se mendoni që fëmija mund të ketë nevojë për shërbime të edukimit special; ose
- Keni kërkuar një vlerësim për fëmijën tuaj; ose
- Mësuesi i fëmijës tuaj ose një anëtar tjetër i personelit të distriktit të shkollës kanë njoftuar drejtorin e distriktit për edukimin special ose anëtarë të tjerë të personelit të menaxhimit në mënyrë të drejtpërdrejtë për shqetësimet specifike për modelin e sjelljes së fëmijës tuaj.

Distrikti i shkollës nuk pritet ta trajtojë fëmijën tuaj si një fëmijë me aftësi të kufizuara nëse keni refuzuar t'ju jepni leje distriktit për të vlerësuar fëmijën tuaj për edukimin special. Kjo është po ashtu e vërtetë nëse keni refuzuar edukimin special dhe shërbimet përkatëse për fëmijën tuaj ose nëse fëmija juaj është vlerësuar dhe ekipi ka vendosur se fëmija juaj nuk ka aftësi të kufizuara. Distrikti mund të marrë masa disiplinore për fëmijën tuaj në të njëjtën mënyrë si për studentët pa aftësi të kufizuara që shfaqin sjellje të njëjta.



Caktimi i njëanshëm i programit të edukimit për fëmijët me aftësi të kufizuara nga prindërit në një shkollë private me shpenzime publike

Proçesi i përcaktimit të rimbursimit

Nëse zgjidhni që ta vendosni fëmijën tuaj në një shkollë private, distrikti nuk është i detyruar të paguajë për koston e edukimit ose të edukimit special dhe shërbimeve përkatëse në shkollën private për sa kohë që distrikti ka ofruar për fëmijën tuaj një edukim publik falas dhe të përshtatshëm (FAPE) në distrikt. Nëse besoni se distrikti nuk ka arritur të ofrojë për fëmijën tuaj një edukim FAPE, ju keni mundësinë të paraqitni një ankesë për procesin e rregullt ku do të zhvillohet një seancë dëgjimore dhe një oficer i paanshëm i seancës do të marrë një vendim për faktin nëse distrikti ka ofruar edukimin FAPE për fëmijën tuaj (Shikoni informacionet për procesin e rregullt në faqet 21-27). Nëse përcaktohet nga një oficer i paanshëm i seancës gjatë procesit të rregullt se distrikti nuk ka ofruar edukimin FAPE, oficeri i seancës mund të vendosë se keni të drejtën të rimbursoheni (të paguheni) për koston e regjistrimit të fëmijës tuaj në një shkollë private.

Zvogëlimi ose humbja e rimbursimit

Shuma që kërkohet të rimbursohet nga distrikti mund të zvogëlohet ose mund ta humbisni plotësisht rimbursimin nëse ndodh një nga sa më poshtë:

- Në takimin e programit IEP që është zhvilluar para largimit të fëmijës tuaj nga shkolla, nuk e keni informuar shkollën se nuk do ta pranoni programin e edukimit të caktuar nga ekipi i programit IEP dhe nuk i keni informuar për shqetësimet tuaja, dhe se planifikoni ta regjistroni fëmijën tuaj në një shkollë private; ose
- Nuk e keni informuar shkollën me shkrim të paktën 10 ditë pune para tërheqjes së fëmijës tuaj nga distrikti se nuk e pranoni programin IEP dhe se planifikoni ta regjistroni fëmijën në një shkollë private. Këto 10 ditë pune përfshijnë ditët e pushimit që bien gjatë fundjavës; ose
- Nëse para largimit të fëmijës tuaj nga shkolla, distrikti ju ka dhënë një njoftim përkatës me shkrim se planifikonte të vlerësonte fëmijën tuaj dhe ju nuk e keni vendosur fëmijën tuaj në dispozicion për vlerësimin; ose
- Një gjykatë përcakton se keni vepruar në mënyrë të paarsyeshme.

Mbrojtja e rimbursimit

Rimbursimi (shuma që do t'ju paguhet) nuk mund të zvogëlohet ose nuk mund të refuzohet pagesa nëse:

- Distrikti ju ka penguar që të paraqitni një njoftim;
- Distrikti nuk ju ka informuar se kërkohej të paraqitni një njoftim; ose
- Paraqitja e njoftimit mund të shkaktoje lëndime fizike për fëmijën tuaj.

Po ashtu, një gjykatë ose oficeri i seancës mund të arrijnë në përfundimin se kostoja e rimbursimit nuk mund t'ju zvogëlohet ose t'ju refuzohet për mosparaqitjen e këtij njoftimi nëse:

- Nuk mund të lexoni ose të shkruani në anglisht; ose
- Paraqitja e njoftimit mund të shkaktoje dëmtime emocionale serioze për fëmijën tuaj.



Njoftimi për prindërit për programet e bursave për studentët me aftësi të kufizuara

Kur bëhet njoftimi

Sa herë që një distrikt i shkollës përfundon një vlerësim për një fëmijë me një aftësi të kufizuar, ose fillon të zhvillojë, të rishikojë ose ndryshojë programin IEP të një fëmije, distrikti duhet të informojë prindin e fëmijës për Programin e bursave për autizmin dhe Programin e bursave Jon Peterson.

Programi i bursave për autizmin

Nëse fëmija juaj merr shërbime të edukimit special në kategorinë e autizmit, mund të kualifikoheni për Programin e bursave për autizmin. Në kuadër të programit, mund të zgjidhni që ta dërgoni fëmijën tuaj në një program të edukimit special të ndryshëm nga ai që zbatohet nga distrikti i shkollës ku banoni, ku fëmija juaj do të marrë edukimin dhe shërbimet e përshkruara në programin e tij IEP.

Për të qenë e përshtatshëm për programin, fëmija juaj:

- Duhet të jetë përcaktuar me autizëm nga distrikti e shkollës ku banoni;
- Duhet të ketë një program aktual IEP nga distrikti i shkollës ku banoni, të cilin e pranoni dhe që është realizuar; dhe
- Duhet të jetë të paktën tre vjeç.

Për informacione mbi Programin e bursave për autizmin, vizitoni faqen e internetit të Departamentit të Edukimit të Ohajos në education.ohio.gov dhe shkruani **Autism Scholarship Program** (Programi i bursave për autizmin) në kutinë e kërkimit ose dërgoni një email në autismscholarship@education.ohio.gov.

Programi i bursave për nevoja të veçanta Jon Peterson

Nëse fëmija juaj merr shërbime të edukimit special, mund të kualifikoheni për Programin e nevojave të veçanta Jon Peterson. Në kuadër të këtij programi, mund të zgjidhni që ta dërgoni fëmijën tuaj në një program të edukimit special të ndryshëm nga ai që zbatohet nga distrikti i shkollës ku banoni, ku fëmija juaj do të marrë edukimin dhe shërbimet e përshkruara në programin e tij IEP.

Për t'u kualifikuar për një Bursë për nevoja të veçanta Jon Peterson, fëmija juaj:

- Duhet të jetë përcaktuar si një fëmijë me aftësi të kufizuara nga distrikti e shkollës ku banoni;
- Duhet të ketë një program aktual IEP nga distrikti i shkollës ku banoni, të cilin e pranoni dhe që është realizuar; dhe
- Duhet të kualifikohet për ndjekjen e kopshtit deri në klasën 12.

Për informacione mbi Programin e bursave për nevoja të veçanta Jon Peterson, vizitoni faqen e internetit të Departamentit të Edukimit të Ohajos në education.ohio.gov dhe shkruani **Jon Peterson Scholarship** (Bursa Jon Peterson) në kutinë e kërkimit ose dërgoni një email në

peterson.scholarship@education.ohio.gov.

Informacione shtesë

Informacionet për programet e bursave janë të disponueshme në faqen e internetit të Departamentit të Edukimit të Ohajos në education.ohio.gov.

Për më shumë informacione ose pyetje mbi këto programe bursash, kontaktoni me:
Zyrën e Opsioneve të Edukimit Jopublik në (614) 466-5743 ose pa pagesë në: (877) 644-6338.

Ohio | Department
of Education

education.ohio.gov